



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2022-16

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës
Gjykatës Roumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 korrik 2022

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Kërkesë Referuese e Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat e tij Themelore të Garantuara nga Neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të Drejtat Themelore të tij të Garantuara nga Neni 7I i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Parashtruesit

Pjetër Shala

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

Vidar Stensland, Kryegjykatës

Roumen Nenkov, Gjykatës

Romina Inkuti, Gjykatëse

Pas diskutimit pa prani fizike, lëshon këtë Vendim

I. PROCEDURA

1. Më 14 prill 2022, z. Pjetër Shala (“parashtruesi”) i dorëzoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Dhoma”)¹ një kërkesë referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”) dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”).² Parashtruesi përfaqësohej nga z. Zhan-Lui Zhilisen dhe z. Hédi Aouini.

2. Në Kërkesën e tij Referuese, parashtruesi u ankua për shkelje të të drejtave themelore në lidhje me procesin penal kundër tij, që zhvillohet para Dhomave të Specializuara (“DHS”). Konkretisht, parashtruesi argumentoi se ndjekja penale e tij bazuar në disa akuza shkelte të drejtat e tij themelore sipas nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”).³

3. Më 26 prill 2022, Dhoma nxori një vendim në të cilin, ndër të tjera, vinte në dukje se në kohën e duhur ajo mund të kërkojë parashtrime shtesë nga parashtruesi dhe

¹ Në lidhje me caktimin e Panelit të Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), shih KSC-CC-2022-16, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 19 prill 2022.

² KSC-CC-2022-16, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të Garantuara nga Neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 7 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, publik, 14 prill 2022 (“Kërkesa Referuese”).

³ Kërkesa Referuese, para. 1, 3, 10-15.

Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS").⁴ Megjithatë, në rrethanat aktuale, Dhoma vendosi se nuk ishin të nevojshme parashtrime shtesë për gjykimin e Kërkesës Referuese.

II. FAKTET

A. AKTAKUZA

4. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit, duke e akuzuar atë për krime lufte të kryera së paku nga 17 maji 1999 deri në 5 qershor 1999 në Kosovë dhe në zonat në Shqipërinë e Veriut.⁵ Akuzat përfshijnë ndalim arbitrar si krim lufte, të pretenduar se është kryer përmes pjesëmarrjes së parashtruesit në një ndërmarrje kriminale të përbashkët ("NKP"), në format e saj bazë dhe të zgjeruar.⁶

1. E drejta zakonore ndërkombëtare

5. Në lidhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare ("DZN"), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi se, sipas nenit 3(2)(d) dhe (3), dhe nenit 12 të Ligjit, DHS-ja zbatoi DZN-në në fuqi në kohën kur u kryen krimet e pretenduara.⁷

2. Ndalimi arbitrar

6. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ndalimi arbitrar nuk parashikohet shprehimisht në nenin 14(1)(c) të Ligjit si krim lufte sipas DZN-së.⁸ Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakttoi se juridiksioni i DHS-së përfshin edhe

⁴ KSC-CC-2020-16, F00003, Vendim mbi Gjuhën e Punës dhe Procesin e Mëtejshëm), 26 prill 2022, publik, f. 3.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, publik, 12 qershor 2020 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021) ("Vendimi i Konfirmimit"), para. 93, 101, 106, 111, 140(a).

⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 85-93, 115-120, 121-124, 129.

⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 13.

⁸ Vendimi i Konfirmimit, para. 23.

krimet e luftës, të cilat përbëjnë një shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës në lidhje me Trajtimin e të Burgosurve të Luftës (“Konventa e Gjenevës”) dhe ndaloreshin nga DZN-ja në kohën e kryerjes, në pajtim me nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit.⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake pohoi se, si heqja e lirisë pa ndonjë bazë ligjore, edhe ndalimi në shkelje të mbrojtjeve bazë, shkelin kushtin për trajtim njerëzor të të gjithë personave jashtë luftimit, sikundër mishërohet në nenin 3 të Konventës së Gjenevës.¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte bindur gjithashtu se ndalimi arbitrar ndalohej nga DZN-ja në kohën e kryerjes së krimeve.¹¹

3. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se parashtruesi, si anëtar i NKP-së në formën e saj bazë dhe, si alternativë, në formën e saj të zgjeruar,¹² i kishte kryer krimet e pretenduara, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.¹³

8. Pas konfirmimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të akuzave kundër parashtruesit, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar më 19 qershor 2020.¹⁴

B. KUNDËRSHTIMET E PARASHTRUESIT NDAJ JURIDIKSIONIT TË DHS-SË

9. Më 12 korrik 2021, parashtruesi dorëzoi një mocion paraprak ku kundërshtonte juridiksionin e DHS-së.¹⁵ Konkretisht, parashtruesi argumentonte se, ndër të tjera, DHS-ja nuk kishte juridiksion në lidhje me NKP-në dhe krimin e ndalimit arbitrar në

⁹ Vendimi i Konfirmimit, para. 23.

¹⁰ Vendimi i Konfirmimit, para. 24-25.

¹¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 26-27.

¹² Vendimi i Konfirmimit, para. 120, 122, 124.

¹³ Vendimi i Konfirmimit, para. 124.

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial, me më pak redaktime dhe versioni publik, i redaktuar më tej i aktakuzës së konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, F00054, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së, 12 korrik 2021, publik (“Mocioni paraprak”).

një konflikt të armatosur jondërkombëtar ("KAJN").¹⁶ Më 18 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzoi mocionin paraprak.¹⁷ Më 8 nëntor 2021, parashtruesi e apeloj vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁸

1. Themelimi i DHS-së

10. Parashtruesi argumentoi se DHS-ja *de facto* është një gjykatë e jashtëzakonshme dhe se, si rrjedhojë, themelimi i saj shkel nenin 103(7) të Kushtetutës.¹⁹ Parashtruesi u shpreh në këtë drejtim se, ndër të tjera: (i) DHS-ja u themelua për të trajtuar një numër të kufizuar çështjesh ligjore; dhe (ii) të gjithë gjykatësit, prokurorët dhe stafi i DHS-së janë ndërkombëtarë dhe se emërimi i tyre devijon nga procedurat e përgjithshme të emërimit të parapara në Kushtetutë dhe në rendin juridik vendor.²⁰

11. Parashtruesi nuk i ngriti në apel parashtrimet e tij në lidhje me kushtetutshmërinë e DHS-së. Përkundrazi, parashtruesi kërkoi sqarim nga Paneli i Gjykatës së Apelit lidhur me natyrën e DHS-së që, sipas argumentimit të parashtruesit, do të "pasqyronte në mënyrë të paevitueshme rolin e DHS-së dhe zbatimin e Ligjit."²¹

2. E drejta zakonore ndërkombëtare

12. Parashtruesi argumentoi se, përveç në qoftë se vërtetohet "standardi i dualizmit", zbatimi i drejtpërdrejt i DZN-së pa ratifikimin e përcaktuar me ligj është

¹⁶ Mocioni paraprak, para. 3, 4, 21, 47.

¹⁷ KSC-BC-2020-04, F00088, Vendim mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 18 tetor 2021, publik ("Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin").

¹⁸ KSC-BC-2020-04/IA002, F00003, Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 9 nëntor 2021, publik ("Apeli").

¹⁹ Mocioni paraprak, para. 7, që pajtohet me KSC-BC-2020-06, F00224, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljeve të Kushtetutës), 15 mars 2021, publik.

²⁰ Mocioni paraprak, para. 7-11.

²¹ Apeli, para. 8.

në kundërshtim me nenet 210 dhe 181 të Kushtetutës së vitit 1974 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (“Kushtetuta e RSFJ-së”), e cila ishte në zbatim gjatë kohës së akuzave, dhe kërkonte që veprat penale të parashihen në ligjet vendore, sikurse konstatoi Gjykata Supreme e Kosovës.²²

13. Vetëm në apel parashtruesi argumentoi se, kur ka ndryshime në kornizat ligjore potencialisht të zbatueshme (Kushtetuta e RFSJ-së, ose Kushtetuta), neni 7 i Konventës kërkon nga DHS-ja t’i krahasojë të dyja dhe të zbatojë atë që është më e favorshme për parashtruesin.²³

14. Parashtruesi argumenton gjithashtu se zbatimi i legjislacionit të vendit i cili penalizon veprime të kryera përpara miratimit të legjislacionit shkel parimin e ligjshmërisë dhe mosprapaveprueshmërisë, siç përcaktohet në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës.²⁴ Konkretisht, parashtruesi argumentoi se nenet 3 dhe 12 të Ligjit nuk janë në pajtim me parimin e mosprapaveprueshmërisë garantuar nga neni 7 i Konventës dhe neni 33 i Kushtetutës.²⁵

15. Parashtruesi pretendoi se përjashtimi i vetëm ndaj parimit të mosprapaveprueshmërisë të ndjekjeve penale në bazë të së drejtës ndërkombëtare pranuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”) ka të bëjë me situatën kur është kryer një sjellje “e paligjshme në mënyrë flagrante”, natyra kriminale e të cilës është “qartësisht” e dukshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin.²⁶

16. Gjithashtu, parashtruesi argumentoi se mospërputhjet dhe paqartësia lidhur me ligjin e zbatueshëm shkelin kriteret e “cilësisë së ligjit”; disponueshmërisë,

²² Apeli, para. 10; Mocioni paraprak, para. 16, 18, që i referohet Gjykatës Supreme të Kosovës (UNMIK), *Çështja kundër Veselin Beshoviqit*, AP-KZ 80/2004, Aktgjykim, 7 shtator 2004 (“Aktgjykimi në çështjen Beshoviq”), f. 18-19.

²³ Apeli, para. 9, 11-12.

²⁴ Apeli, para. 4(ii), 12, 14-19; Mocioni paraprak, para. 4, 13-15, 17.

²⁵ Apeli, para. 12, 14-15; Mocioni paraprak, para. 4, 13-14.

²⁶ Apeli, para. 16, 18.

parashikueshmërisë dhe saktësisë së nenit 33 të Kushtetutës, të interpretuar në përputhje me nenin 7(1) të Konventës.²⁷

2. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

17. Lidhur me formën e përgjegjësive penale të NKP-së, parashtruesi së pari, pretendon se nuk ekziston baza ligjore për këtë formë përgjegjësie penale në Ligj, sidomos pasi që neni 16(1)(a) i Ligjit nuk e përfshin NKP-në si formë të përgjegjësive penale.²⁸ Parashtruesi argumentoi se përgjegjësia për NKP-në nuk ishte e parashikueshme dhe e disponueshme për të në vitin 1998, sikurse kërkohet në nenin 7 të Konventës dhe dispozitat e barasvlershme të Kushtetutës.²⁹ Së fundi, parashtruesi pretendoi se NKP-ja në format e saj bazë dhe të zgjeruar nuk ishte pjesë e DZN-së në atë kohë³⁰ dhe argumentoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se NKP-ja në formën e zgjeruar është në përputhje me parimin e fajësisë individuale.³¹

3. Ndalimi arbitrar

18. Sipas parashtruesit, ndalimi arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jo ndërkombëtar (KAJN) nuk është “përfshirë saktë në aktakuzë” sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.³² Konkretisht, parashtruesi argumentoi se formulimi i qartë i nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe parimi i sigurisë juridike ndalojnë interpretimin e kësaj dispozite sikur i jep juridiksion DHS-së mbi ndalimin arbitrar në një KAJN.³³ Për më tepër, parashtruesi pretendoi se ndalimi arbitrar nuk ishte penalizuar në ligjin vendor të Kosovës apo në DZN në kohën e kryerjes së tij.³⁴

19. Së fundi, parashtruesi argumentoi se, duke pasur parasysh pasiguritë e lidhura

²⁷ Apeli, para. 4(i), 7-9, 12; Mocioni paraprak, para. 5, 12, 44-45, 60.

²⁸ Apeli, para. 20; Mocioni paraprak, para. 21, 29-32.

²⁹ Apeli, para. 20, 22; Mocioni paraprak, para. 44-45.

³⁰ Apeli, para. 21; Mocioni paraprak, para. 4, 21, 33-43.

³¹ Apeli, para. 22; Mocioni paraprak, para. 24.

³² Apeli, para. 23, *Shih gjithashtu*, Mocioni paraprak, para. 3-4, 47.

³³ Apeli, para. 23; Mocioni paraprak, para. 51.

³⁴ Apeli, para. 23; Mocioni paraprak, para. 47, 49-50, 52-59.

me nocionin e arbitraritetit të ndalimit dhe në mungesë të ndonjë rregulle vendore apo ndërkombëtare që ndalonte heqjen arbitrare të lirisë në një KAJN në kohën përkatëse, parashtruesi nuk mund ta kishte parashikuar se mund të akuzohej për këtë krim.³⁵

C. RRËZIMI I KUNDËRSHTIMEVE TË PARASHTRUESIT

20. Më 11 shkurt 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë kundërshtimet e parashtruesit lidhur me juridiksionin e DHS-së.³⁶

1. E drejta zakonore ndërkombëtare

21. Në lidhje me karakterin ligjor të DHS-së, Paneli i Gjykatës së Apelit u shpreh se “Nuk është kategorizimi i Dhomave të Specializuara si një lloj i veçantë gjykate që përcakton të drejtën e zbatueshme, por vetë Ligji.”³⁷ Lidhur me zbatueshmërinë e DZN-së, Paneli kujton se DZN-ja zbatohet në Kosovë nëpërmjet përfshirjes së “normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare” në kornizën ligjore të Kosovës, në nenin 19(2) të Kushtetutës, dhe se nuk ka ndonjë bazë ligjore për të kërkuar dispozitë të barasvlershme në ligjin vendor të zbatueshëm në kohën e krimeve të pretenduara.³⁸

22. Konkretisht, Paneli deklaroi se Kushtetuta e RSFJ-së nuk e kufizon juridiksionin e DHS-së, duke qenë se DHS-ja ka për detyrë vetëm të zbatojë Kushtetutën që është në fuqi aktualisht.³⁹ Rrjedhimisht, Paneli kujtoi se aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, të cituara nga parashtruesi në mbështetje të argumenteve të tij se DZN-ja

³⁵ Apeli, para. 23; mocioni paraprak, para. 47, 60.

³⁶ KSC-BC-2020-04, IA002, F00010, Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 11 shkurt 2022 (“Vendimi i Apelit”).

³⁷ Vendimi i Apelit, para. 19.

³⁸ Vendimi i Apelit, para. 18; që i referohet to KSC-BC-2020-06, IA009, F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, 23 dhjetor 2021, publik (“Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët”), para. 24.

³⁹ Vendimi i Apelit, para. 20; që i referohet *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 25-26.

nuk zbatohet për ngjarje që pretendohet se kanë ndodhur në vitin 1999, nuk janë relevante, sepse kanë të bëjnë me një kornizë të ndryshme kushtetuese.⁴⁰

23. Për sa i takon pretendimit të parashtruesit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i detyruar të vlerësonte sistemin ligjor më të favorshëm për të akuzuarin, Paneli i Gjykatës së Apelit u shpreh se: (i) argumenti i parashtruesit ishte i vonuar;⁴¹ (ii) parimi i *lex mitior* ka të bëjë me krahasimin midis legjislacioneve penale;⁴² (iii) kundërshtimet lidhur me të drejtën penale të zbatueshme nuk përbëjnë kundërshtime të juridiksionit;⁴³ dhe (iv) DZN-ja është e detyrueshme për të gjitha shtetet, rrjedhimisht Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ishte i detyruar të krahasonte parimet e ligjshmërisë midis dy kushtetutave.⁴⁴

24. Sa i takon ndërhyrjes së pretenduar në parimin e ligjshmërisë përmes zbatimit të DZN-së, Paneli kujton se neni 12 i Ligjit nuk e ngre çështjen e prapaveprueshmërisë, duke qenë se juridiksioni lëndor i DHS-së kufizohet nga DZN-ja, që zbatohet në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, përpara shpalljes së Ligjit.⁴⁵

25. Për sa i takon çështjes nëse përfshirja e një norme ndërkombëtare që përcakton një vepër penale në ligjin vendor është një aspekt i rëndësishëm për vlerësimin e përputhshmërisë së procedurave penale me nenin 7 të Konventës, Paneli erdhi në përfundimin se z. Shala keqinterpretoi jurisprudencën që citonte,⁴⁶ dhe se GJEDNJ-ja

⁴⁰ Vendimi i Apelit, para. 20; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 27; që i referohet, *inter alia*, Gjykata Supreme të Kosovës, *Gashi dhe të tjerët*, AP-KZ 139/2004, Aktgjykim, 21 korrik 2005 (“Aktgjykimi *Gashi dhe të tjerët*”), f. 8; Aktgjykimi *Beshoviq*, pp. 18-19.

⁴¹ Vendimi i Apelit, para. 30.

⁴² Vendimi i Apelit, para. 30; që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Nikolić*, IT-94-2-A, Judgment on Sentencing Appeal, 4 February 2005, para. 80; ECtHR, *Del Rio Prada v. Spain*, no. 42750/09, Judgment, 21 October 2013, para. 116; *Vasiliauskas v. Lithuania*, Judgment, 20 October 2015, para. 154; *Kokkinakis v. Greece*, no. 14307/88, Judgment, 25 May 1993, para. 52.

⁴³ Vendimi i Apelit, para. 30; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 52-59.

⁴⁴ Vendimi i Apelit, para. 30; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 25.

⁴⁵ Vendimi i Apelit, para. 24, 25; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 38; që u referohet neneve 12, 13(1) dhe 14(1) të Ligjit.

⁴⁶ Vendimi i Apelit, para. 26; që i referohet ECtHR, *Korbely v. Hungary* [GC], no. 9174/02, Judgment, 19 September 2008, para. 75.

konfirmoi në të njëjtin aktgjykim se është pranuar gjerësisht që termi “ligj” në nenin 7(1) të Konventës përfshin si ligjin e shkruar ashtu edhe të pashkruar.⁴⁷

26. Për më tepër, Paneli i rrëzoi parashtrimet e z. Shala se jurisprudenca e GJEDNJ-së e lejon ndjekjen penale në bazë të së drejtës ndërkombëtare pa përfshirjen e saj në ligjin vendor në kohën në fjalë vetëm në lidhje me sjelljen “e paligjshme në mënyrë flagrante”, natyra kriminale e së cilës është “dukshëm” e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin.⁴⁸ Paneli e interpretoi standardin e GJEDNJ-së se nuk kërkohet domosdoshmërisht një sjellje “e paligjshme në mënyrë flagrante”, por se natyra “e paligjshme në mënyrë flagrante” e sjelljes së të akuzuarit duhet ta ketë bërë natyrën e saj kriminale të parashikueshme sipas nenit 7(1) të Konventës.⁴⁹

27. Sa i takon pyetjes se a ka DZN-ja parësi ndaj ligjit vendor, Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi konkretisht nëse njohja e parësisë së DZN-së në Ligj përputhet me Kushtetutën e Kosovës.⁵⁰ Gjithsesi, Paneli kujtoi konstatimin e tij të mëparshëm se DZN-ja ka epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe se sidomos nuk është në kundërshtim me formulimin e nenit 19(2) të Kushtetutës, sikundër sugjerohet nga parashtruesi.⁵¹ Dhënia parësi DZN-së nuk do ishte e papajtueshme me nenin 16 të Kushtetutës, “i cili flet për raportin midis Kushtetutës, nga njëra anë, dhe ligjeve dhe akteve të tjera juridike, nga ana tjetër”.⁵²

2. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

28. Paneli pajtohet me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se neni

⁴⁷ Vendimi i Apelit, para. 26; ECtHR, *Korbely v. Hungary* [GC], no. 9174/02, cituar më lart, para. 70.

⁴⁸ Vendimi i Apelit, para. 28.

⁴⁹ Vendimi i Apelit, para. 28, që i referohet, ndër të tjera, ECtHR, *Streletz et al. v. Germany*, nos. 34044/96, 35532/97, 44801/98, Judgment, 22 March 2001, para. 77-78, 87-88.

⁵⁰ Vendimi i Apelit, para. 18.

⁵¹ Vendimi i Apelit, para. 18, 20-21, që i referohet *Vendimit të Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 23-24.

⁵² Vendimi i Apelit, para. 18.

16(1) i Ligjit duhet interpretuar në përputhje me DZN-në, siç zbatohet në kohën e krimeve të pretenduara, sepse: (i) DZN-ja ka epërsi ndaj legjislacionit vendor në Dhomat të Specializuara; (ii) nenet 13-14 të Ligjit, në bazë të të cilave janë ngritur akuzat ndaj të akuzuarit, i referohen konkretisht DZN-së; dhe (iii) terminologjia e nenit 16(1) të Ligjit është në fakt identike me dispozitat përkatëse të tribunalëve *ad hoc*.⁵³

29. Paneli kujtoi më tej se ishte bindur se Ligji e parasheh NKP-në si formë përgjegjësie dhe se DHS-ja mund të mbështetet në jurisprudencën e gjykatave të tjera, përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë dhe Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën për të trajtuar rastet kur Ligjit i mungon shtjellimi ligjor.⁵⁴

30. Në lidhje me faktin nëse NKP-ja ishte pjesë e DZN-së në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, Paneli kujtoi konstatimin e tij të mëparshëm se NKP-ja, në formën bazë dhe të zgjeruar të saj, është një formë përgjegjësie sipas DZN-së, përfshirë në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.⁵⁵ Paneli nuk gjeti ndonjë gabim në vlerësimin nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të jurisprudencës në këtë drejtim.⁵⁶

31. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se vendimet e Gjykatës të Apelit të Kosovës, të cilat parashtruesi i përdori për të mbështetur argumentin e tij se NKP-ja ishte e pazbatueshme në Kosovë, u nxorën sipas një kornize të ndryshme ligjore.⁵⁷ Gjithashtu, Paneli vuri në dukje se Gjykata Supreme e Kosovës në raste të shumta ka konstatuar se të gjitha format e përgjegjësisë lidhur me NKP-në ishin “të përcaktuara qartë” sipas DZN-së.⁵⁸

⁵³ Vendimi i Apelit, para. 35; Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin, para. 91.

⁵⁴ Vendimi i Apelit, para. 35. *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 136-138.

⁵⁵ Vendimi i Apelit, para. 37. *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 172, 196.

⁵⁶ Vendimi i Apelit, para. 37, Shih gjithashtu, *Vendimin e Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 153, 169 (në lidhje me rolin e shkrimeve akademike në përcaktimin e DZN-së), 187, 190-193 (në lidhje me devijimin e Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias lidhur me NKP-në III).

⁵⁷ Vendimi i Apelit, para. 38, që i referohet Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin, para. 90.

⁵⁸ Vendimi i Apelit, para. 38; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 193, 223, që i referohet jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Kosovës.

32. Në lidhje me parashikueshmërinë dhe disponueshmërinë e NKP-së, Paneli kujtoi konstatimin e tij se NKP-ja, në formën e vet bazë dhe të zgjeruar, ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuar të tjerë në kohën e kryerjes së saj.⁵⁹

3. Ndalimi arbitrar

33. Sa i takon pyetjes se a ka DHS-ja juridiksion mbi ndalimin arbitrar në një KAJN, Paneli i Gjykatës së Apelit la në fuqi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se formulimi i nenit 14(1)(c) të Ligjit sugjeron se lista nuk është shteruese dhe se juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet me aktet e renditura shprehimisht në nenin 14(1)(c) të Ligjit.⁶⁰ Paneli konstatoi më tej se gjuha joshteruese e dispozitës nuk shkel parimin e sigurisë juridike. Paneli gjykoi se, që një veprim të përfshihet në Ligj, dhe kështu në juridiksionin e DHS-së, duhet të ketë ekzistuar sipas DZN-së gjatë juridiksionit kohor dhe duhet të përbëjë një shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së Gjenevës.⁶¹

34. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së Gjenevës.⁶² Për më tepër, Paneli kujtoi se ndalimi bëhet arbitrar dhe përbën një shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së Gjenevës kur shkelet parimi i trajtimit njerëzor, pavarësisht nëse ka një bazë ligjore për ndalimin e një personi.⁶³ Së fundi, Paneli e la në fuqi konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se: (i) ndalimi arbitrar gjatë KAJN-së përbënte vepër penale në kohën e kryerjes së saj; dhe (ii) ishte i disponueshëm dhe i parashikueshëm për z. Shala në kohën në fjalë se përfshirja në

⁵⁹ Vendimi i Apelit, para. 36, që i referohet *Vendimit të Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 211-214, 218-224.

⁶⁰ Vendimi i Apelit, para. 44; Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin, para. 99, Shih gjithashtu, *Vendimin e Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 87.

⁶¹ Vendimi i Apelit, para. 44.

⁶² Vendimi i Apelit, para. 45; Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin, para. 100.

⁶³ Vendimi i Apelit, para. 45; *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 95-97.

veprime të ndalimit arbitrar mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale.⁶⁴

III. SHKELJET E PRETENDUARA

35. Parashtruesi u ankua para Dhomës se as forma e përgjegjesisë e NKP-së, as krimi i luftës i ndalimit arbitrar nuk ishin pjesë e ligjit vendor që zbatohet gjatë periudhës së aktakuzës.⁶⁵ Parashtruesi argumentoi se u akuzua për krime sipas DZN-së në përputhje me Ligjin dhe se një zbatim i tillë i drejtpërdrejt i DZN-së shkel të drejtat e tij sipas nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.⁶⁶ Gjithashtu, parashtruesi argumentoi se neni 7 i Konventës, i lexuar bashkërisht me parimin *in dubio pro reo*, kur ka dallim midis kornizave të ndryshme ligjore potencialisht të zbatueshme (Kushtetuta e RSFJ-së, ose Ligji), kërkon që DHS-ja të zbatojë atë më të favorshmen.⁶⁷

36. Parashtruesi pretendoi gjithashtu se akuzat kundër tij të bazuara në ndalimin arbitrar ose në formën e përgjegjesisë të NKP-së shkelin parimin e ligjshmërisë dhe mosprapaveprueshmërisë, siç përcaktohet në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës sepse: (i) dispozitat përkatëse u zbatuan në mënyrë prapavepruese për sjellje që nuk ishte e ndaluar në kohën e kryerjes së saj;⁶⁸ dhe (ii) ndalimi arbitrar dhe NKP-ja nuk ishin pjesë e DZN-së në vitin 1998.⁶⁹ Rrjedhimisht, parashtruesi kërkoi që nenet 3 dhe 12 të Ligjit të shpallehin të papajtueshme me nenin 33 të Kushtetutës sepse lejojnë futjen në rendin juridik të Kosovës të veprave që burojnë nga DZN-ja që ndryshe nuk ishin të përfshira në rendin e brendshëm juridik në kohën e kryerjes së tyre.⁷⁰

⁶⁴ Vendimi i Apelit, para. 46; Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Juridiksionin, para. 102, Shih gjithashtu, *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 106-109, 111.

⁶⁵ Kërkesa Referuese, para. 15, 48, 49-50, 62-66.

⁶⁶ Kërkesa Referuese, para. 3, 16, 18.

⁶⁷ Kërkesa Referuese, para. 43-44.

⁶⁸ Kërkesa Referuese, para. 3, 10, 15, 18-19, 21, 49, 50, 61-65, 75.

⁶⁹ Kërkesa Referuese, para. 51-62, 67-75.

⁷⁰ Kërkesa Referuese, para. 41-42.

37. Së fundi, parashtruesi argumentoi se të njëjtat dispozita kërkojnë që e drejta penale të jetë e qartë, e saktë, e disponueshme dhe e parashikueshme për një të akuzuar dhe se këto kritere lidhur me “cilësinë e Ligjit” nuk u plotësuan për shkak të pasigurisë për sa i përket karakterizimit të DHS-së dhe Ligjit.⁷¹

IV. JURIDIKSIONI

38. Dhoma kujton se parashtruesi e dorëzoi Kërkesën Referuese sipas nenit 113(7) të Kushtetutës. Dhoma vëren gjithashtu se parashtruesi ngriti disa ankesa në lidhje me procesin kundër tij që po zhvillohet para DHS-së. Në veçanti, parashtruesi pretendon se ndjekja penale e tij bazuar në disa akuza të caktuara shkelte të drejtat e tij themelore të garantuara nga Kushtetuta. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese lidhet me DHS-në dhe ZPS-në, sikundër kërkohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Nga kjo del se Dhoma ka juridiksion të vendosë për Kërkesën Referuese.

V. PRANUESHMËRIA

A. TË DREJTAT KUSHTETUESE NË DISKUTIM

39. Në fillim, Dhoma vëren se parashtruesi ankohet se ndjekja e tij penale bazohet në disa akuza që shkelin të drejtat e tij themelore të garantuara nga Kushtetuta. Konkretisht, parashtruesi ankohet se ndalimi arbitrar si krim lufte dhe NKP-ja si formë përgjegjësie penale individuale: (i) bazohen në një burim të pazbatueshëm ligji, konkretisht në DZN, pa miratimin e ndonjë ligji vendor; (ii) nuk parashihen në Ligj; dhe (iii) nuk përbënin krime sipas DZN-së gjatë periudhës së aktakuzës (shih paragrafët 35-37 më lart).

40. Dhoma vëren se ankesat e parashtruesit ngrenë kryesisht një aspekt sipas nenit 33 të Kushtetutës. Duke qenë se parashtruesi u mbështet edhe në nenin 7 të Konventës,

⁷¹ Kërkesa Referuese, para. 20-21, 24-25.

Dhoma kujton se, për shkak të nenit 22(2) dhe (3) të Kushtetutës, këto garanci zbatohen në nivel kushtetues.⁷² Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka theksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara nga instrumente ndërkombëtare në nenin 22 të Kushtetutës “kanë statusin e normave në nivel kushtetues dhe janë pjesë përbërëse e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera që përmban Kushtetuta”.⁷³

41. Mbështetur në sa më lart, duke qenë autoriteti përfundimtar që bën cilësimin juridik të fakteve të çështjes që ka në shqyrtim,⁷⁴ Dhoma konstaton se Kërkesa Referuese duhet shqyrtuar sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.

42. Megjithatë, përpara se Dhoma të mund të shqyrtojë themelësinë e Kërkesës Referuese, duhet të përcaktojë së pari nëse është e pranueshme.⁷⁵ Kështu Dhoma i kthehet vlerësimit të disa kriterëve për pranueshmëri të parapara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregulloren e Procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Rregullorja”), që dalin në procesin aktual.

⁷² Shih KSC-CC-2022-14, F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, publik, 13 qershor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit”), para. 34. Shih gjithashtu, KSC-CC-2020-08, F00020/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese i [REDAKTUAR] në vijim të një Vendimi të Gjykatës të Vetëm, publik, 20 prill 2020 (“Vendimi në lidhje me një Vendim të Gjykatës të Vetëm”), para. 61; KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit”), para. 14.

⁷³ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjytimeve* [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH. nr. 21/2019, të 5 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111.

⁷⁴ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 35; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 15.

⁷⁵ Shih *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 36, Shih gjithashtu, *Vendimin në lidhje me një vendim të Gjykatës të Vetëm*, para. 37.

B. A JANË ANKESAT E PARASHTRUESIT TË PARAKOHSHME

43. Dhoma kujton se, sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit, individët autorizohen t'i referojnë Dhomës “shkelje të pretenduara [...] të të drejtave të tyre individuale dhe lirive të garantuara me Kushtetutë [...]”. Rregulla 14(f) e Rregullores parasheh që një kërkesë referuese është e papranueshme kur asgjë në këtë Kërkesë Referuese nuk krijon përshtypjen e shkeljes së një të drejte kushtetuese.

44. Sikurse u vu në dukje më lart, parashtruesi pretendoi se disa akuza kundër tij shkelin nenet 16 dhe 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës. Në të njëjtën kohë, procesi penal kundër parashtruesit është duke u zhvilluar dhe akuzat në diskutim nuk janë vendosur ende. Rrjedhimisht, pyetja e parë që del është nëse ankesat e parashtruesit, në këtë fazë të procesit penal, janë të parakohshme dhe, më konkretisht, a mund të pretendojë parashtruesi se është viktimë e shkeljeve të pretenduara.⁷⁶

1. A mund të pretendojë parashtruesi se është viktimë

(a) Parashtrimet

45. Parashtruesi lë të kuptohet se tashmë është bërë viktimë e shkeljeve të pretenduara me ngritjen e akuzave ndaj tij, edhe pse këtë temë nuk e trajton shprehimisht në Kërkesën e tij Referuese.⁷⁷

(b) Vlerësimi i Dhomës

46. Dhoma kujton së pari se parashtruesi ankohet se është “akuzuar” në shkelje të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës. Rrjedhimisht shtrohet pyetja nëse

⁷⁶ Shih *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 38.

⁷⁷ Kërkesa Referuese, para. 1, 10, 19, 61 (“Ndjekja penale e z. Shala për krime që pretendohen se janë kryer përmes NKP-së shkel të drejtën e tij për të mos u akuzuar për një veprim i cili nuk përbënte vepër penale në kohën që është kryer.”) (theksimet i shtuar), 75 (“Mbrojtja kërkon që DHSGJK-ja të deklarojë se akuza e ndalimit arbitrar në KAJN shkel të drejtat e z. Shala sipas nenit 33 të Kushtetutës dhe Nenit 7 të KEDNJ-së dhe duhet të hiqet nga Aktakuza.”) (theksi i shtuar).

Kushtetuta përmban ndonjë garanci për të mos u “akuzuar” për një vepër penale për shkak të një sjelljeje që nuk ka përbërë vepër penale sipas ligjit në kohën e kryerjes së saj.

47. Në këtë drejtim, në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, Dhoma ka vënë re më parë dallimin midis nenit 33(1) të Kushtetutës në gjuhën anglishte dhe në shqipe, i cili në pjesën përkatëse thotë se, “askush nuk akuzohet” (theksi i shtuar, përkthyer nga shqipja) dhe nenit 33(1) të Kushtetutës në serbishte, i cili thotë se “askush nuk shpallet fajtor [...]” (theksi i shtuar; përkthyer nga serbishtja).⁷⁸ Dhoma kujton se sipas nenit 5(1) të Kushtetutës, të dyja, shqipja dhe serbishtja janë gjuhë zyrtare në Kosovë.⁷⁹ Rrjedhimisht, si tekstet në gjuhën shqipe, ashtu dhe në serbishte të nenit 33(1) të Kushtetutës janë të barasvlershme.

48. Për sa i takon zgjidhjes së dallimit në formulimet në tekstin në gjuhën shqipe dhe serbishte, Dhoma i referohet konstatimeve të veta në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, sipas të cilave neni 33(1) i Kushtetutës i interpretuar në bazë të nenit 7 të Konventës përmban vetëm garancinë për të mos u shpallur fajtor për shkak të një sjelljeje e cila nuk përbënte vepër penale sipas ligjit në kohën e kryerjes së saj dhe po ashtu nuk i referohet të akuzuarit si person i “akuzuar”.⁸⁰

49. Dhoma vëren se parashtruesi nuk është “shpallur fajtor” për veprat penale në diskutim. Në këto rrethana, parashtruesi nuk mundet, në këtë fazë të procesit penal,

⁷⁸ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 42. Teksti në anglishte është botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, parë më 30 maj 2022. Në shqip: “Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet [...]” Teksti në shqip siç është botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008 në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, parë më 30 maj 2022. Në serbishte: “Niko se ne može proglasiti krivim ili kazniti [...]” Teksti në serbishte sikundër është botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, parë më 30 maj 2022.

⁷⁹ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 44, Shih gjithashtu, nenin 5(4) të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 1 mars 2007, i cili parashihet se të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës nxirren dhe botohen në gjuhët zyrtare dhe se versionet e gjuhëve zyrtare janë të barasvlershme, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>, parë më 30 maj 2022.

⁸⁰ *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 49-53.

të kërkojë të jetë viktimë e shkeljeve të pretenduara të nenit 33 të Kushtetutës ose nenit 7 të Konventës.⁸¹

2. Përfundim

50. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se, në këtë fazë të procedurave, Kërkesa Referuese e parashtruesit është e parakohshme dhe si e tillë, nuk të jep përshtypjen se janë shkelur të drejtat e parashtruesit sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës. Si rrjedhojë, Kërkesa Referuese duhet të deklarohet e papranueshme sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores.⁸²

51. Ndërsa Dhoma konstaton se Kërkesa Referuese duhet rrëzuar për arsyet e lartpërmendura, ajo kujton se, sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit, dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores, një person mund t'i paraqesë një kërkesë referuese Dhomës pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të parapara në ligj kundër shkeljes së pretenduar. Në këtë drejtim, Dhoma vëren se, sipas nenit 47 të Ligjit, Paneli i Gjykatës Supreme të DHS-së, në raste të përcaktuara konkretisht, dëgjon apelet kundër një aktgjykimi të Panelit të Gjykatës së Apelit dhe se neni 48(6), (7) i Ligjit parashikon që, në rastin e një aktgjykimi të formës së prerë, një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të dorëzohet në Panelin e Gjykatës Supreme të DHS-së, ndër të tjera, për shkelje të së drejtës penale.

52. Si rrjedhojë, del se ky është një nga mjetet juridike që do të duhej të shfrytëzohej për në kontekst të shterimit të mjeteve juridike lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.⁸³ Por, duke qenë se Kërkesa

⁸¹ *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 53.

⁸² *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 55.

⁸³ Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML nr. 242/2017 i 30 prillit 2018*, KI 01/19, Aktvendimi për papranueshmëri, 2 shtator 2020 (1 tetor 2020), para. 31-41, 82-85, 91-93; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme PML nr. No. 247/2017 i 6 shkurtit 2018*, KI95/18, Aktvendimi për papranueshmëri, 27 maj 2019 (19 gusht 2019), para. 3, 12-17, 22; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pml nr. 63/2018 i 4 qershorit 2018*, KI 155/18, Aktvendimi për papranueshmëri, 25 shtator 2019 (21 tetor

Referuese është e parakohshme, Dhoma gjykon se nuk ka nevojë të japë vendim lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike në këtë kohë.

53. Në të njëjtën kohë, Dhoma vëren se Kërkesa Referuese e parashtruesit ngre një çështje të rëndësishme në lidhje me kornizën ligjore të DHS-së. Konkretisht, parashtruesi argumenton se, si parim i përgjithshëm, zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së lidhur me akuzën e ndalimit arbitrar dhe NKP-së si formë përgjegjësie, bie ndesh me Kushtetutën dhe se parësia e dhënë DZN-së është antikushtetuese. Duke pasur parasysh natyrën thelbësore të këtyre aspekteve në funksionimin e DHS-së, Dhoma e gjykon të përshtatshme t'i trajtojë ato dhe të kujtojë konstatimet e saj të mëparshme për disa nga këto aspekte.⁸⁴ Në të njëjtën kohë, dhe sikundër Dhoma ka përcaktuar më herët, duke pasur parasysh se procesi penal kundër parashtruesit është në vijim e sipër dhe si rrjedhojë Kërkesa Referuese është e parakohshme, Dhoma duhet të jetë e kujdesshme që të mos ndërhyjë në këtë fazë në rolin e paneleve të tjera të DHS-së në përcaktimin e aspekteve juridike dhe faktike që kanë të bëjnë me lëndën penale para tyre.⁸⁵

C. A DUKET SE ËSHTË KRYER SHKELJE PËR SHKAK TË ZBATIMIT TË DREJTPËRDREJTË TË DZN-SË DHE PËR SHKAK TË DHËNIES PARËSI DZN-SË NGA DHS-JA

1. Fushëveprimi i vlerësimit

54. Sikurse del nga praktika e mëhershme e Dhomës, është detyrë e paneleve kompetente të DHS-së të vendosin mbi faktet dhe provat, si edhe të interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat ligjore relevante për lëndën para tyre.⁸⁶ Dhoma vetëm mund të

2019), para. 4, 20-25, 29, 36-39, 45-52. Shih gjithashtu, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit Pml nr. 141/2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 2 korrikut 2018 dhe vendimit P nr. 571/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës i 2 shkurtit 2018*, KI 158/18, Aktvendimi për papranueshmëri, 12 prill 2019 (23 prill 2019), para. 40-41.

⁸⁴ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 64-81.

⁸⁵ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 58.

⁸⁶ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 59. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës shqiptuar nga 26 marsi deri në*

vlerësojë konstatimet e tyre në qoftë se kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.⁸⁷

55. Bazuar në sa më lart, Dhoma mendon se në këtë fazë të procesit, mund të japë mendim vetëm për një çështje më të përgjithshme, pra, nëse zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së nga DHS-ja për krimet e luftës, përfshirë format e përgjegjesisë, dhe ndikimin e DZN-së në Kushtetutë, krijojnë përshtypjen se është shkelur Kushtetuta, sipas rregullës 14(f) të Rregullores.

56. Dhoma kujton se vlerësimi i saj nuk cenon asnjë vendim të ardhshëm për ankesat, në qoftë se do të ketë, të cilat parashtruesi mund t'i ngrejë para Dhomës lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, lidhur me një vendim konkret për përgjegjësinë e tij, në qoftë se vërtet do të ketë një vendim të tillë.⁸⁸

2. Parashtrimet

57. Parashtruesi thotë se zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së është në kundërshtim me nenet 210 dhe 181 të Kushtetutës së RFSJ-së, të cilat, sikundër u shpreh Gjykata Supreme e Kosovës, zbatoheshin gjatë kohës së kryerjes së veprës penale dhe e bënin DZN-në të pazbatueshme për ngjarjet që pretendohet se kanë ndodhur në vitin 1999.⁸⁹ Sipas parashtruesit, përveç në qoftë se përmbushet "standardi i dualizmit", DZN-ja nuk do të ishte e zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.⁹⁰

12 prill 2018 KI 96/18 dhe të tjerët, Aktvendimi për papranueshmëri, 19 shkurt 2019 (27 shkurt 2019), para. 51; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr.225/2-17 të 18 dhjetorit 2017*, KI 37/18, Aktvendimi për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 39; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA-II-KZ-II-7/15 i 26 nëntorit 2015*, KI 15/16, Aktvendimi për papranueshmëri, 16 mars 2016 (5 Prill 2016), para. 40.

⁸⁷ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 59; *Vendimi mbi një Vendim të Gjykatës të Vetëm*, para. 36.

⁸⁸ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 61.

⁸⁹ *Kërkesa Referuese*, para. 17; Aktvendimi në Çështjen Gashi dhe të tjerët, f. 6, 12; Aktgjykimi *Beshoviq*, f. 18-19.

⁹⁰ *Kërkesa Referuese*, para. 16-17.

58. Gjithashtu, parashtruesi u ankua se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit kishin shkelur të drejtën e tij, sepse e drejta penale nuk duhet të interpretohet në dëm të tij, sikundër garantohet në nenin 7 i Konventës dhe parimin *in dubio pro reo*. Konkretisht, parashtruesi pretendoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Dhoma e Gjykatës së Apelit, pavarësisht nga ekzistenca e jurisprudencës së kundërt në Gjykatën Supreme të Kosovës, të cilat ngrenë dyshime për ligjin e zbatueshëm, nuk i krahasuan dy sistemet potencialisht të zbatueshme (Kushtetuta e RFSJ-së dhe Kushtetuta e Kosovës) dhe nuk zbatuan atë që ishte më e favorshme për parashtruesin.⁹¹ Për këtë qëllim, parashtruesi kërkoi që nenet 3 dhe 12 të Ligjit të shpallehin të papajtueshme me nenin 33 të Kushtetutës sepse lejojnë përfshirjen në rendin juridik të Kosovës të veprave që burojnë nga DZN-ja, të cilat ndryshe nuk ishin të përfshira në rendin juridik vendor në kohën përkatëse.⁹²

59. Gjithashtu, sipas parashtruesit, zbatimi i DZN-së shkel nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës dhe parimet e ligjshmërisë dhe mosprapaveprueshmërisë të parapara në to.⁹³ Parashtruesi argumentoi se, gjithsesi, përfshirja e DZN-së në sistemin juridik nuk përmbushte kriteret e disponueshmërisë, parashikueshmërisë dhe saktësisë që kërkohen në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7(1) të Konventës.⁹⁴ Konkretisht, parashtruesi pretendoi se refuzimi i perceptuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit për të përcaktuar karakterin juridik të DHS-së e la parashtruesin të pasigurt se cili ligj zbatohet nga DHS-ja, mënyrën e interpretimit të Ligjit, si dhe rolin e jurisprudencës së tribunalëve penalë ndërkombëtarë në gjykimet nga panelet e DHS-së.⁹⁵

60. Së fundi, sipas parashtruesit, konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe të Panelit të Gjykatës së Apelit shkelin nenin 16 të Kushtetutës, i cili garanton

⁹¹ Kërkesa Referuese, para. 43-44.

⁹² Kërkesa Referuese, para. 41-42.

⁹³ Kërkesa Referuese, para. 18-19, 41-42.

⁹⁴ Kërkesa Referuese, para. 20-24.

⁹⁵ Kërkesa Referuese, para. 25.

parësinë e Kushtetutës së Kosovës në rendin juridik të brendshëm.⁹⁶ Sipas parashtruesit, mungesa e qartësisë lidhur me parësinë e DZN-së apo të Kushtetutës gjithashtu do të kontribuonin në mungesën e “cilësisë” së ligjit të zbatueshëm, në shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.⁹⁷

3. Vlerësimi i Dhomës

(a) A mund të zbatohet DZN-ja drejtpërdrejt dhe parësia e Kushtetutës së Kosovës.

61. Fillimisht, Dhoma kujton konstatimin e vet të mëparshëm në *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit* se neni 19 i Kushtetutës nuk kufizohet me çështjen e zbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, por ka të bëjë me burime të tjera të së drejtës ndërkombëtare.⁹⁸ Dhoma vuri re më tej se neni 19(2) i Kushtetutës u referohet “normave ligjërishit detyruese të së drejtës ndërkombëtare” dhe nga kjo del se këto norma të së drejtës ndërkombëtare rrjedhin nga një burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare të ndryshme nga traktatet ndërkombëtare.⁹⁹ Për qëllimet e këtij rishikimi, një burim i tillë, pa dyshim, është DZN-ja.¹⁰⁰ Rrjedhimisht, normat ligjërishit detyruese të së drejtës ndërkombëtare në nenin 19(2) e përfshijnë DZN-në.

62. Dhoma kujton se, sipas nenit 19(2) të Kushtetutës, normat ligjërishit detyruese të së drejtës ndërkombëtare, si marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, “kanë parësi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”. Në këtë drejtim, Dhoma vëren se legjislacioni i Kosovës zbatohet drejtpërdrejt. Kështu, për të garantuar se, në një zbatim të tillë të legjislacionit vendor, norma përkatëse ligjore detyruese e të drejtës ndërkombëtare ka

⁹⁶ Kërkesa Referuese, para. 22-24.

⁹⁷ Kërkesa Referuese, para. 24.

⁹⁸ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 68.

⁹⁹ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 68.

¹⁰⁰ Shih nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili pasqyron burimet e së drejtës ndërkombëtare të njohura zyrtarisht.

parësi, sikundër parashikohet në nenin 19(2), duhet të ekzistojë mundësia që një normë e tillë të zbatohet drejtpërdrejt.¹⁰¹

63. Sikurse Dhoma ka konstatuar më herët, ajo nuk ka nevojë të përcaktojë nëse, sipas nenit 19 të Kushtetutës, një normë e DZN-së zbatohet drejtpërdrejt në sistemin juridik të brendshëm të Kosovës.¹⁰² Pyetja që shtrohet para Dhomës është më e kufizuar, sepse ka të bëjë me normat e DZN-së që lidhen me veprat në diskutim, konkretisht, për sa u takon krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, përfshirë format përkatëse të përgjegjësisë. Në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, Dhoma konstatoi se këto krime dhe forma përgjegjësie janë të zbatueshme drejtpërdrejt në procedurat para DHS-së sipas nenit 3(2)(a), (d) të Ligjit, të cilat nga ana e tyre i referohen nenit 19(2) të Kushtetutës, përveç kur janë të papajtueshme me Kushtetutën, veçanërisht me nenin 33 të Kushtetutës.¹⁰³ E njëjta gjë vlen edhe në rrethanat aktuale.

64. Dhoma pajtohet me Panelin e Gjykatës së Apelit se nenet 145(2) dhe 162(2) të Kushtetutës e bëjnë të qartë se Kushtetuta zëvendëson çdo kushtetutë të zbatueshme më parë dhe se DHS-ja është e detyruar të zbatojë vetëm Kushtetutën aktualisht në fuqi, sipas nenit 3(2) të Ligjit.¹⁰⁴ Ky përfundim theksohet në nenin 16(1) dhe (3) të Kushtetutës, që parasheh se ligjet dhe aktet e tjera juridike “duhet të jenë në përputhje me këtë Kushtetutë” dhe se çdo njeri dhe subjekt në Kosovë i “nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”

¹⁰¹ Shih *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 69.

¹⁰² Dhoma vëren praktikën e gjykatave të Kosovës në një fushë tjetër nga ajo që është para Dhomës në rastin konkret. Në veçanti, gjykata e Kosovës në një lëndë që ka të bëjë me një kërkesë për ekstradimim e një personi, mori në shqyrtim nëse Kosova ishte palë e traktatit i cili u paraqit si bazë për ekstradimim. Në këtë kontekst konkret, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se disa norma në fushën e pjesëmarrjes së shteteve në traktate ndërkombëtare janë të pasqyruara në DZN dhe, si rrjedhojë, iu referua asaj. Në këtë rast, Gjykata Supreme e Kosovës deklaroi gjithashtu se “epërsia e të drejtës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në Kosovë parashihet në nenin 19, paragrafi 2, i Kushtetutës [...]”. Shih Kosovë, Gjykata Supreme, Pn-Kr-386/2010, Vendimi, 7 shtator 2010, f. 4, 6.

¹⁰³ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 70-72, 78.

¹⁰⁴ *Vendimi i Apelit në Çështjen Thaçi dhe të tjerët*, para. 26.

65. Rrjedhimisht Dhoma vëren se argumenti i parashtruesit që lartëson parimin *lex mitior* në një normë kushtetuese, pra, se në rastin e dy sistemeve kushtetuese potencialisht të zbatueshme (Kushtetuta e RSFJ-së dhe Kushtetuta e Kosovës) duhet zbatuar sistemi më i favorshëm për parashtruesin, është i gabuar. Argumenti nuk mund të ketë sukses duke pasur parasysh nenet 16(1), (3) dhe 145 të Kushtetutës. DHS-ja mund të zbatojë vetëm një sistem kushtetues, që është Kushtetuta e Kosovës.

66. Për më tepër, Dhoma ka parasysh se parimi i ligjshmërisë ndalon zbatimin prapaveprues të veprave penale dhe dënimeve të reja, që nuk kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës së ndëshkueshme të pretenduar. Megjithatë, ky parim nuk e ndalon një rend kushtetues të ri që të zbatojë drejtpërdrejt të drejtën ndërkombëtare; që ka qenë në fuqi në kohën e veprës penale të pretenduar. Ajo që ka rëndësi është nëse veprat penale kanë qenë të përkufizuara sipas të drejtës (penale) vendase apo ndërkombëtare. Kjo pasqyrohet në nenin 33(1) të Kushtetutës, i cili përjashton hapur krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Dhoma gjykon se ky përfundim mbështetet më tej nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila ka përcaktuar vazhdimisht se është plotësisht e ligjshme që autoritetet e drejtuara nga sundimi i ligjit të ndërmarrin procedura penale kundër personave pas ndryshimit të rendit kushtetues.¹⁰⁵

67. Prandaj, parashtruesi nuk mund të pretendojë se krijohet përshtypja sikur është shkelur neni 33(1) i Kushtetutës dhe neni 7(1) i Konventës kur vjen puna tek zbatueshmëria e Kushtetutës së Kosovës para DHS-së, dhe jo e Kushtetutës së RSFJ-së.

¹⁰⁵ Krahaso, ECtHR, *Kononov v. Latvia*, no. 36376/04, 2008, para. 114(f); *K.-H.W. v. Germany* [GC], no. 37201/97, 2001, para. 84.

(b) A është zbatimi i drejtpërdrejt i DZN-së në përputhje me nenin 33 të Kushtetutës

68. Dhoma kujton konstatimin e vet në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit* se një dispozitë e DZN-së mund të jetë pjesë e “të drejtës ndërkombëtare” në nenin 33(1) të Kushtetutës, kur vepra ishte e përcaktuar në kohën e kryerjes së saj me disponueshmëri dhe parashikueshmëri të mjaftueshme nga DZN-ja.¹⁰⁶ Dhoma vuri në dukje se GJEDNJ-ja ka përcaktuar se aspekti i parashikueshmërisë përfshin një element interpretimi gjyqësor, sepse do të jetë gjithnjë e nevojshme të qartësohen pikat e dyshimta.¹⁰⁷ Siç konstatoi Dhoma, neni 7 i Konventës nuk mund të interpretohet se e bën të paligjshëm sqarimin gradual të rregullave të përgjegjesisë penale përmes interpretimit ligjor rast pas rasti, me kusht që zhvillimi rezultues të jetë në pajtim me thelbin e veprës penale dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme.¹⁰⁸

69. Rrjedhimisht, zbatimi i drejtpërdrejtë nga DHS-ja i krimeve të luftës kundër njerëzimit, përfshirë format e përgjegjesisë sipas DZN-së, për të provuar fajësinë e një personi është në pajtim me Kushtetutën (sikurse është shpjeguar më lart tek pika (a), me kusht që një zbatim i tillë të jetë në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës, sikurse interpretohet nga GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj.¹⁰⁹

70. Dhoma vëren se nuk i takon Dhomës të vendosë në këtë fazë nëse NKP-ja dhe ndalimi arbitrar në të vërtetë parashihen në DZN dhe nëse ishin të disponueshme dhe të parashikueshme në kohën e kryerjes së tyre, por i takon paneleve të tjera të DHS-së të vendosin sipas kompetencave të tyre përkatëse.¹¹⁰

71. Gjithashtu, Dhoma vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar natyrën e DHS-së si një gjykatë e specializuar e ngritur në bazë të sistemit juridik të

¹⁰⁶ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 75-77.

¹⁰⁷ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 77.

¹⁰⁸ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 77.

¹⁰⁹ *Shih Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 78.

¹¹⁰ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Krasniqit dhe Veselit*, para. 80.

Kosovës dhe rrjedhimisht kjo nuk shpie në ndonjë pasiguri që do të dobësonte “cilësinë” e ligjit të zbatueshëm.¹¹¹

72. Si rezultat i konstatimeve të mësipërme se nuk krijohet përshtypja për shkelje të të drejtave themelore në këtë kohë, Dhoma e rrëzon më tej si të papranueshme kërkesën e parashtruesit për t'i shpallur nenet 3 dhe 12 të Ligjit të papajtueshme me nenet 19 dhe 33 të Kushtetutës.

4. Përfundim

73. Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma konstaton se në Kërkesën Referuese nuk zbulon ndonjë shkelje në dukje sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës sa i përket zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë nga DHS-ja të krimeve të luftës sipas DZN-së, përfshirë format e lidhura të përgjegjësisë penale individuale. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Kërkesës Referuese, në këtë fazë të procesit, duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores.

VI. KËRKESA PËR SEANCË GJYQËSORE

74. Në Kërkesën Referuese, parashtruesi i kërkon Dhomës të caktojë një seancë gojore.¹¹²

75. Dhoma kujton se, sipas rregullës 15(4) të Rregullores, pas përfundimit të afateve për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim, Dhoma vendos për një kërkesë referuese në bazë të parashtrimeve me shkrim, përveçse kur seanca gojore është në interes të

¹¹¹ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318, KO 26/15*, Aktvendim, 14 prill 2015 (15 prill 2015), para. 43, 58-59, 65-66, 68, 71-72.

¹¹² Kërkesa Referuese, para. 76.

administrimit të duhur të drejtësisë. Në rrethanat aktuale, Dhoma gjykon se mund të vendosë për Kërkesën Referuese pa pasur nevojë për seancë.

76. Duke marrë parasysh sa më lart, kërkesa e parashtruesit për seancë gojore duhet hedhur poshtë.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

1. *E deklaron* Kërkesën Referuese të z. Pjetër Shala të papranueshme; dhe
2. *E rrëzon* Kërkesën Referuese në tërësi.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte të mërkurë, 6 korrik 2022
Në Hagë, Holandë